



BASHKIA
TIRANË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E OBJEKTEVE NË BASHKËPRONËSI,
ADMINISTRIMIT TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE
DHE EMERGJENCAVE CIVILE
DREJTORIA E OBJEKTEVE NË BASHKËPRONËSI
DHE ADMINISTRIMIT TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____, 2019

Lënda: **Kthim përgjigje**

Njësia Administrative Tiranë

E nderuar znj.

Në përgjigje të kërkesës tuaj me nr. prot. _____ datë _____ 9, ju bëjme me dije se:

Nisur nga problematikat e shumta të qytetarëve në administrimin e pallateve dhe mjedisëve të përbashkëta, Bashkia e Tiranës ndërmoi këtë nismë, për të zbatuar Ligjin Nr. 10112, datë 9.4.2009 për "Administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit".

Drejtorja e Objekteve në Bashkëpronësi dhe Administrimit të Njësive Administrative, në zbatim të ligjit nr. 10112, datë 09.04.2009, "Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit", dhe VKB nr. 45, datë 06.07.2016 për "Ngritjen e Task Forcë-s për regjistrimin e asambleve të bashkëpronësisë dhe administratorëve të bashkëpronësisë", ka udhëhequr dhe ka koordinuar punën e task- forcës për objektet në bashkëpronësi, duke ndjekur etapat si mëposhtë:

1. Thirrja e mbledhjes së parë të asamblesë së bashkëpronarëve për zgjedhjen e kryesisë
2. Zhvillim i mbledhjes së parë të asamblesë së bashkëpronarëve
3. Thirrja e mbledhjes së dytë të asamblesë së bashkëpronarëve për zgjedhjen e kryesisë
 - a. Nëse mbledhja e parë e asamblesë nuk është zhvilluar, task forca ka plotësuar njoftimin tip për mbledhjen e dytë të asamblesë së bashkëpronarëve.
4. Zhvillim i mbledhjes së dytë të asamblesë së bashkëpronarëve

Në rastet kur Asambleja e bashkëpronarëve ka marrë vendimin për zgjedhjen e kryesisë dhe administratorit, nga Bashkia e Tiranës është proceduar me regjistrimin e tyre në regjistrat përkatës, konkretisht:

janë regjistruar 3662 kryesi në "Regjistrin e Bashkëpronësisë",
janë certifikuar 934 administratorë në "Librin e Administratorëve" dhe
aktualisht rezultojnë 1268 pallate që administrohen sipas kontratave të lidhura midis administratorëve dhe asambleve të godinave në bashkëpronësi.

Duke qenë së gjatë këtij projekti, janë hasur problematika lidhur me zbatimin e ligjit, Drejtoria jonë ka zhvilluar takime me grupet e interesit, ku janë propozuar edhe ndryshime me qëllim

ermirësimin e tyre. Nga këto takime, është hartuar një projekt-draft, ku është vënë në dijeni Ministria e linjës, e cila do vijojë me procedurat e mëtejshme sipas dispozitave ligjore

Ju falenderojmë për mirëkuptimin.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



Erindi Bejko